



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

**Lenda: “MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN MANUSHAQE
KAPLLANI”**

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “, VKB-së nr.3, datë 30.01.2026 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

E ndjera znj.Manushaqe Kapllani, rreth moshës 65 vjecare, anëtare e komunitetit egjiptian, person i identifikuar në situatë rruge edhe pse kishte banesë të qëndrueshme, njëhej si nga komuniteti dhe të afërm që qëndronte në ambiente publike të papërshtatshme. Gjatë vizitave në familje nga strukturat e shërbimeve shoqërore, personi paraqitej me vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë si ushqimi, higjiena dhe së fundmi edhe paqëndrueshmëri mendore dhe emocionale. E ndjera shfaqte herë pas here edhe nevojën për ndihmë mjekësore dhe mbështetje sociale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vajza e vetme e saj, e martuar dhe me tre fëmijë të mitur rezulton që edhe ajo përballet me vështirësi ekonomike apo sociale. Është familje e identifikuar nga shërbimi social si me vështirësi social ekonomike dhe është përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, programeve të strehimit social duke e referuar pranë edhe institucioneve për riintegrimin në tregun e punës.

E ndjera dhe vajza e saj janë ndjekur nga strukturat e shërbimit social dhe ju është ofruar përherë ndihmë emergjente dhe plane integrimi social

Situata financiare :

Duke u bazuar në historikun, problematikat e rastit dhe vlerësimin social nga strukturat e shërbimit social, person e cila nuk zotëron asnjë pasuri, pamundësive financiare për të përballuar shpenzimet e varrimit nga vajza e saj, kërkesës së paraqitur nga *znj.Liljana Kapllani, drejtorja e Shërbimit Social*, propozon të përballoj shpenzimet e varrimit, në shumën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Drejtorja / Sektori përgjegjës

Drejtorja e Financës dhe Drejtorja e Shërbimit Social.

A është objekt i konsultimit publik:

Jo.Nuk është objekt konsultimi

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 28 /05/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERËN MANUSHAQE KAPLLAN**”

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste fatkeqësie, për të ndjerën Manushaqe Kapllani në shumën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
2. Shuma prej 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2026.
3. Pagesa do të bëhet për llogari të subjektit që ka lëshuar faturën tatimore, i cili mundësojë shërbimin e varrimit.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 28 /05/2026